

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

1. MATERIALE KËRKIMORE	7
2. AKTIVITETE KËRKIMORE	9
3. LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA	12

Numri 33 i materialit "Të Rejat Shkencore në Bankën e Shqipërisë" pasqyron disa nga punët kërkimore të sapo përfunduara, punët kërkimore në proces, artikujt, si dhe aktivitetet kryesore kërkimore shkencore të zhvilluara nga ekonomistët e Bankës së Shqipërisë, gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2024.

1. MATERIALE KËRKIMORE

1.1 MATERIALE KËRKIMORE TË PËRFUNDUARA

Kërkimi shkencor në Bankën e Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe është orientuar drejt materialeve dhe analizave empirike që kanë pasur në fokus tematika mbi politikën monetare, stabilitetin financiar, digjitalizimin, ndryshimet klimatike, globalizimin dhe tregtinë, të ardhurat nga emigrantët, performancën e sistemit bankar, çmimet e banesave etj. Në mënyrë të përmbledhur, ato paraqiten më poshtë:

"Bilanci i Bankës Qendrore dhe inflacioni në një ekonomi të vogël të hapur të Euroizuar: Një analizë e bashkintegruar Svar", nga Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, Altin Tanku, Departamenti i Kërkimeve, (BSH).

Banka e Shqipërisë nuk ka zbatuar politika tradicionale të bilancit; megjithatë, ajo ka ndërmarrë një sërë veprimesh politike që

kanë rritur pjesën e jhuamarrësve në raport ndaj huamarrësve në bazën monetare dhe në detyrimet e bilancit të saj. Autorët synojnë të hetojnë nëse këto ndryshime në strukturën e bilancit të bankës qendrore kanë shkaktuar goditje monetare shtesë me efekte të drejtpërdrejta në inflacion. Hipoteza testohet duke vlerësuar një model të vogël strukturor VAR me tregues të politikës dhe të jopolitikës të integruar të rendit I(1) dhe I(0). Autorët identifikojnë kufizimet afatgjata bazuar në strukturën e integruar të procesit të gjenerimit të të dhënave, siç përcaktohet nga marrëdhëniet e integritit. Gjetjet sugjerojnë se një rritje e peshës së komponentit jhuamarrës të bazës monetare ka efekte pozitive direkte dhe indirekte në inflacion. Autorët argumentojmë se identifikimi i kësaj goditjeje monetare ka implikime të rëndësishme për bankën qendrore dhe politikën e saj monetare. Materiali është publikuar në revistën "Public Sector Economics", vol. 48, nr. 4, 2024.

“Kultura Financiare dhe mirëqenia e të rriturve në Shqipëri: Rezultate nga raundi i vitit 2023”, nga Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve, (BSH)

Raporti paraqet disa nga rezultatet e nxjerra nga raundi i katërt i “Vrojtimin mbi Kulturën Financiare të të Rriturve në Shqipëri”, zhvilluar nga Banka e Shqipërisë gjatë periudhës qershor-korrik 2023, duke kontribuar në Vrojtimin Ndërkombëtar të të Rriturve mbi Kulturën Financiare të koordinuar nga OECD/INFE (Organisation for Economic Co-operation and Development/International Network on Financial Education). Të dhënat për vitin 2023, tregojnë se indeksi i kulturës financiare të individëve në Shqipëri është 59 (nga 100 që është niveli maksimal). Ky indeks na tregon se individët zotërojnë 59% të totalit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve të duhura financiare. Ky vlerësim rezulton i ngjashëm me mesataren e 39 vendeve pjesëmarrëse në këtë vërtetim ndërkombëtar që rezultoi 60 (nga 100) dhe qëndron pak më poshtë se mesatarja e vendeve të OECD-së prej 63 (nga 100).

Në lidhje me njohjen dhe përdorimin e produkteve financiare, individët në Shqipëri karakterizohen nga një nivel i lartë i njohjes së produkteve financiare, por një nivel më i ulët i përdorimit të tyre. Indeksi i mirëqenies financiare së individëve në Shqipëri vlerësohet 31 (nga 100, që është vlera maksimale), dhe rezulton më i ulët se mesatarja e vendeve që kanë marrë pjesë në vërtetim si dhe e vendeve të OECD-së me përkatësisht 42 (nga 100) dhe 47 (nga 100). Kjo tregon se pjesëmarrësit në vërtetim janë të pakënaqur me situatën e tyre financiare.

“Globalizimi i tregtisë (mallrave mjedisore), rritja ekonomike dhe produktiviteti i punës në vendet e Ballkanit Perëndimor”, nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve, (BSH)

Në një kohë zhvillimesh të shpejta dhe risish teknologjike, shumë autorë mendojnë për efektivitetin e politikave kombëtare dhe sesi globalizimi i tregtisë dhe shkëmbimi i mallrave dhe teknologjive ka ndikim mbi mjedisin dhe se si një proces i integritit në tregun botëror, ofron mundësinë e rritjes së ardhshme ekonomike dhe produktivitetit duke marrë në konsideratë edhe shqetësimet në rritje në lidhje me rreziqet si pasojë e ndryshimeve klimatike. Në përgjithësi, ekonomia e vendeve dhe roli i konkurrencës në zhvillimet tregtare janë aspekte të rëndësishme në rritjen e moderuar ekonomike, produktivitetin dhe formimin e kapitalit, ndërsa periudha që nga viti 2000, pasqyron progresin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në aspektin tregtar. Megjithatë mbetet ende shumë më për të bërë në drejtim të sektorit të eksporteve, thithjes së investimeve dhe inovacionit dhe teknologjisë.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë ecurinë dhe rendimentin e shkëmbimeve tregtare dhe mallrave me ndikim pozitiv në mjedis në vendet e Ballkanit Perëndimor sa i përket rritjes ekonomike, formimit të kapitalit dhe produktivitetit gjatë periudhës 2000-2022. Për këtë arsye, analiza empirike bazohet në një grup të dhënash vjetore në panelin që përbëhet nga tregues makroekonomikë, financiarë dhe atyre të lidhur me shkëmbimet tregtare për Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.

“Një analizë e prirjes globalizuese (apo shkëputjes) të tregtisë së mallrave (mjedisore) në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor”, nga Gerti Shijaku dhe Elona Mulgeci, Departamenti i Kërkimeve, (BSH).

Ky punim analizon nëse goditjet e shpeshta negative, p.sh. kriza globale financiare, tensionet tregtare SHBA-Kinë, Brexit, pandemia Covid-19 dhe agresioni rus në Ukrainë, kanë ndikuar prirjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor për thellimin e shkëmbimeve tregtare midis tyre dhe vendeve të tjera partnere, veçanërisht në rastin e mallrave dhe teknologjisë me ndikim të drejtpërdrejtë në ndryshimet klimatike.

Për këtë arsye, ky punim bazohet në të dhënat vjetore të shkëmbimeve tregtare dypalëshe, midis vendeve të ndryshme, për periudhën 2002-2022, ndërkohë që volumi i shkëmbimeve tregtare në raport ndaj PBB-së u përshtat edhe ndaj distancës gjeografike midis vendeve partnere. Kjo lejon të dallohet më mirë aftësia e vendeve që përtej sasisë së mallrave të tregtuara midis tyre arrijnë të krijojnë lidhje tregtare me vende pozicioni gjeografik i shkëmbimeve tregtare të cilave shtrihet më lart krahasuar me një vend tjetër, duke na dhënë mundësinë të analizohet fakti nëse shkëmbimet tregtare priren drejt globalizimit apo rajonizimit.

“Transformimi digjital i bankave në Shqipëri. Pyetësori mbi digjitalizimin 2024”, nga Margerita Topalli; Lindita Molishti, Departamenti i Kërkimeve, (BSH).

Ky studim paraqet gjetjet e detajuara të Pyetësorit mbi Digjitalizimin 2024 për sektorin bankar shqiptar, të kryer nga Banka e Shqipërisë. Ai eksploron ndikimin e inovacioneve teknologjike në transformimin

digjital, duke theksuar përfitime të tilla si: efikasiteti operacional, shërbimi i përmirësuar ndaj klientit dhe forcimi i menaxhimit të rrezikut. Pyetësori gjithashtu identifikon sfidat me të cilat përballen bankat gjatë transformimit digjital, të tilla si: rreziqet e sigurisë kibernetike dhe mangësitë e edukimit digjital të popullsisë.

Materiali ofron një pasqyrë të qasjeve të institucioneve bankare mbi adoptimin dhe perspektivat e teknologjive si Inteligjenca Artificiale (AI), Automatizimi i Procesit Robotik (RPA) dhe Blockchain. Studimi nënvizon motivimet strategjike për iniciativat digjitale, të tilla si kalimi drejt modeleve të përqendruara te klientët dhe përafrimi me direktivat e BE-së si DORA. Gjetja kryesore nënvizon se digjitalizimi nuk është më një prirje opsionale, por një reformë strukturore që rifordon peizazhin bankar të Shqipërisë, duke nxitur përgjegjshmërinë ndaj klientëve dhe përshtatshmërinë konkurruese.

“Përzgjedhja e strukturës së rrjetit neural me një ilustrim mbi përcaktuesit e çmimit të banesave në Shqipëri”, Blerina Vika, Prof. i Asoc., Departamenti i Statistikave dhe Informatikës së Zbatuar, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve, (BSH).

Literatura empirike mbi rrjetet neurale (NN) vazhdon të zgjerohet në të gjitha fushat e ekonomisë, megjithatë metodologjia e përdorur për ndërtimin dhe specifikimin e modeleve NN kërkon ende shumë testime për të identifikuar strukturën më të mirë që i shërben çështjes në fjalë. Ndryshe nga metodat tradicionale ekonometrike, rrjetet neurale mund të trajtojnë vlerësime që përmbajnë një numër parametrash shumë më të madh sesa numri i observimeve. Prandaj, kompleksiteti i një rrjeti neural

ndryshon me përzgjedhjen e numrit të burimeve (dhe vonesave të tyre), shtresave të fshehura dhe neuroneve.

Ky artikull diskuton çështjet kryesore të hasura në projektimin, specifikimin dhe vërtetimin e strukturës së rrjetit neural të përdorur për analizimin ose parashikimin e variablave ekonomike. Pas diskutimit metodologjik, ne shtjellojmë se si vendimet merren në praktikë gjatë procedurës së përzgjedhjes së modelit. Për ilustrim, kemi përdorur rrjetin e memories së gjatë afatshkurtër (LSTM) në një ushtrim që analizon faktorët e rritjes së çmimeve të banesave në Shqipëri në vitet e fundit. Ata janë shqyrtuar në lidhje me një sërë treguesish të bazuar në teori, si PBB për frymë, kredia bankare për pasuri të paluajtshme, investimet e huaja në tregun e banesave, qiraja e banesave, normat e interesit, kostot e ndërtimit, rritja e popullsisë urbane dhe ndërtimi i shtëpive të reja, lejet.

Rezultatet mbi vlerat optimale të hiperparametrave sugjerojnë që gjatë ndërtimit të një rrjeti neural, praktikuesit mund të dëshirojnë të fokusohen në strukturat e modelit që përbëhen deri në dy vonesa të burimeve, tre shtresa të fshehura, mbi tridhjetë neurone dhe rreth 67,600 parametra. Së fundi, analiza jonë e bazuar në aftësinë parashikuese tregon se ecuria e mëparshme e çmimeve të banesave dhe të ardhurat për frymë janë treguesit më të rëndësishëm që ndihmojnë në shpjegimin e tendencave të fundit të çmimeve të banesave.

1.2 MATERIALE KËRKIMORE NË PROCES

“Prova e rezistencës së bankave ndaj rreziqeve të tranzicionit klimatik në Shqipëri” nga Banka Botërore, Banka e Austrisë, Banka e Shqipërisë (Departamenti

i Kërkimeve, Departamenti i Stabilitetit Financiar)

Ky studim vlerëson ndikimet makroekonomike dhe financiare të rreziqeve të tranzicionit lidhur me ndryshimet klimatike për sektorin bankar në Shqipëri. Analiza eksploron efektet e zbatimit të taksave të karbonit nën dy skenarë: një tranzicion “të rregullt” dhe një tranzicion “të çrregullt”. Skenari i rregullt parashikon një rritje graduale dhe të parashikueshme të taksave të karbonit, duke i lejuar bizneset dhe familjet të përshtaten në mënyrë progresive, ndërsa skenari i çrregullt përfshin një zbatim të papritur, duke shkaktuar tronditje të mëdha afatshkurtra. Korniza përfshin parametrat kryesore makroekonomike, si PBB-ja, inflacioni dhe treguesit fiskalë, për të vlerësuar ndikimin e tyre në qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Gjithashtu, analizohen efektet sektoriale, duke u fokusuar në bujqësi, industri dhe shërbime, për të kuptuar ndikimet më të gjera të procesit të tranzicionit në një ekonomi me emetime më të ulëta karboni. Rezultatet theksojnë rolin vendimtar të hartimit të kujdesshëm të politikave për të minimizuar tronditjet ekonomike dhe për të siguruar qëndrueshmërinë financiare. Politikëbërësit këshillohen të shohin me prioritet strategji tranzicioni të strukturuar dhe transparente për të rritur qëndrueshmërinë dhe për të mbështetur përparimin e Shqipërisë drejt qëllimeve klimatike, ndërkohë që trajtojnë rreziqet financiare të lidhura me këtë tranzicion.

“Vlerësimi i ndikimit të politikave për zbutjen e ndryshimeve klimatike në Shqipëri”, nga Anjeza Kadilli, Co-director CAS Sustainable Finance & Haute Ecole de Gestion HES-SO Geneva, Meri Papavangjeli, Margerita Topalli, Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve, (BSH)

Ky studim synon të ndihmojë politikëbërësit në përmirësimin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe mbështetjen e procesit të tranzicionit drejt një ekonomie të gjelbër, duke adresuar sfidat dhe mundësitë e politikave të zbutjes së ndryshimeve klimatike. Ai analizon ndikimin e politikave për zbutjen e ndryshimeve klimatike në ekonominë shqiptare, duke u fokusuar në vendosjen e taksave të karbonit dhe efektet makroekonomike dhe sociale të tyre.

Gjithashtu, ai shqyrton strukturën ekonomike të Shqipërisë, përbërjen e energjisë dhe ndotjen, duke trajtuar emetimet e karbonit dhe rolin e burimeve të rinovueshme. Në vijim, studimi paraqet një kornizë për politikën e zbutjes së ndryshimeve klimatike në Shqipëri, me një fokus të veçantë në vendosjen e taksave mbi karbonin dhe vlerëson ndikimet e pritshme të këtyre politikave në treguesit makroekonomikë, ekonominë familjare dhe metrikat shoqërore, si dhe ndikimin e tyre në reduktimin e emetimeve të karbonit. Punimi diskuton gjithashtu politikën e rishpërndarjes dhe implikimet e tyre për zbatimin e taksave të karbonit, duke ofruar një qasje të plotë dhe të strukturuar për politikëbërësit.

“Vështrim mbi reformën monetare të vitit 1965, arsyet, natyra e saj dhe konfuzioni jetëgjatë në referimin e vlerës së monedhës kombëtare”, nga Altin Tanku, Besa Prela, Departamenti i Kërkimeve, (BSH)

Artikulli studion reformën monetare të vitit 1965 në kontekstin e ngjarjeve historike dhe zhvillimeve të ekonomisë së brendshme e ndërkombëtare. Kërkimi ynë gjen se planifikimi dhe implementimi i reformës monetare ka ndodhur/koinciduar në një moment të rëndësishëm në këndvështrimin ekonomik e financiar për ekonominë e

vendëve socialiste, me të cilat realizohej një pjesë e konsiderueshme e transaksioneve të sektorit të jashtëm të ekonomisë shqiptare.

Duke diskutuar karakteristikat e organizimit dhe të planifikimit qendror të ekonomisë socialiste në Shqipëri, studimi hedh hipotezën se reforma mund të jetë nxitur edhe nga faktorë të jashtëm përtej argumenteve të paraqitura së brendshmi. Kjo mund të jetë edhe një nga arsyet për mos “referimin e drejtë” të saj nga popullata, duke nxitur një keqkuptim që vazhdon ende për pothuajse 60 vjet. Metoda e studimit është kryesisht observimi dhe analiza e fakteve ekonomike e dokumentare të lidhura me reformën dhe literaturës përkatëse mbi organizimin e ekonomisë të centralizuar.

“Vlerësimi i sentimentit dikotomik në raportet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë”, nga Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve (BSH).

Synimi i këtij projekti kërkimor është të arrijë një vlerësim sasior të sentimentit dikotomik të pranishëm në raportet tremujore të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Vlerësimi do të bazohet në raportin e termave “hawkish” (pozitivë) dhe “dovish” (negativë), i cili përfshin si fjalët kyçe ashtu edhe frazat kyçe të përdorura brenda tekstit të raporteve, dhe do të sintetizojë një indeks të vetëm që evidenton periudhat kohore kur terminologjia “hawkish” ose “dovish” mbizotëron në komunikimin e Bankës. Në përputhje me stokun teorik të literaturës përkatëse, indeksi është planifikuar të testohet për korrelacion me normat afatmesme dhe afatgjata të interesit: si të titujve shtetërorë, dhe depozitave dhe kredive të bankave tregtare

“Lidhja midis të ardhurave nga emigrantët dhe varfërisë në Shqipëri”, nga Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve, (BSH)

Materiali analizon ndikimin që të ardhurat nga emigrantët kanë në treguesit e varfërisë në Shqipëri, duke përdorur valën e parë të të dhënave nga Anketa e Pasurisë së Familjeve Shqiptare. Të dhënat e familjeve tregojnë se të ardhurat nga emigrantët janë një pjesë jetike e të ardhurave të familjeve dhe më pak se një e treta e familjeve kanë marrë të ardhura prej tyre në vitin 2018. Bazuar në vlerësuesit e përputhjes së rezultateve të prirjes (propensity score matching estimators), është analizuar efekti që kanë të ardhurat nga emigrantët në probabilitetin e familjeve për të qenë të varfër. Rezultatet e vlerësuar bazuar në efektin mesatar të trajtimit për familjet e trajtuara (ATT) dhe efektin mesatar të trajtimit (ATE) treguan se të ardhurat nga emigrantët kanë ndikim pozitiv në të ardhurat për të gjitha familjet. Për më tepër, të ardhurat nga emigrantët kanë kontribuar në reduktimin e përqindjes së popullatës që jetojnë nën kufirin e varfërisë duke konfirmuar rëndësinë e tyre për familjet në Shqipëri.

“Rezervat ndërkombëtare, kursi i këmbimit dhe zhvillimi financiar: Përvoja nga rajoni i vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore”, nga Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve, (BSH)

Studimi analizon ndikimin e rezervave ndërkombëtare në stabilitetin e kursit real të këmbimit (RER) në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE), duke u fokusuar në mënyrën se si niveli i zhvillimit financiar të vendit ndikon në këtë marrëdhënie. Duke përdorur metodologjinë e regresionit panel me prag, analiza tregon se rezervat ndërkombëtare mund

të luajnë një rol kyç në stabilizimin e kursit real të këmbimit, veçanërisht në vendet me sisteme financiare më pak të zhvilluara. Studimi eksploron gjithashtu efektin e hapjes financiare dhe ndërlihdjen e saj me efektivitetin e rezervave për të stabilizuar goditjet e jashtme në vendet në zhvillim. Rezultatet ofrojnë perspektiva të vlefshme për politikëbërësit mbi administrimin optimal të rezervave dhe strategjitë për zhvillimin financiar në këto vende.

“Efektet dinamike të treguesve makroekonomikë dhe bankarë në përfitueshmërinë e bankave në Shqipëri: Një qasje të dhënash panel me frekuencë të përzier”, nga Lorena Skufi, Erjona Suljoti, Departamenti i Politikës Monetare, Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve, (BSH)

Materiali synon të analizojë ndikimin e treguesve makroekonomikë dhe bankarë në rentabilitetin e bankave në Shqipëri gjatë periudhës 2009-2024. Në këtë kuadër, qëllimi ynë është të integrojmë të dhënat me frekuencë të lartë dhe të ulët duke përdorur metodologjinë e Integritit të Frekuencave për të dhëna Panel (Mixed Data Sampling), e cila bazohet në funksionet e shpërndarjes së vonesave kohore. Analiza fokusohet në rentabilitetin e bankave, duke e trajtuar si një funksion të faktorëve të ndryshëm, përfshirë raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, aktivitetin ekonomik, aktiveve, normën e huadhënies, inflacionin, huatë e këqija dhe kursin e këmbimit. Ky studim kontribuon në literaturën e fushës, duke ofruar një vështrim të thelluar mbi efektet dinamike të treguesve me frekuencë të lartë në performancën e bankave, duke shmangur në këtë mënyrë problematikën e parametrizimit të tepërt që mund të lindë nga përdorimi i thjeshtë i vonesave kohore.

“Çmimi i banesave dhe qëndrimi i politikës monetare në Shqipëri”, Erjona Suljoti, Departamenti i Politikës Monetare, Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve, (BSH)

Ky studim përqipet të analizojë lidhjen midis pasurisë së tregut të banesave dhe treguesve makroekonomikë në Shqipëri. Analiza përdor të dhëna tremujore për periudhën 1998-2023 dhe mbështetet në metoda të ndryshme, të tilla si: VAR bajesian dhe ajo e korigjimit të gabimit vektorial me vlerësime jolineare për të matur reagimin afatgjatë dhe afatshkurtër të produktit të brendshëm ndaj ndryshimeve të përhershme në pasurinë e banesave. Rezultatet pritet të hedhin dritë nëse: (i) ekziston një lidhje e rëndësishme shumëdrejtimëshe midis çmimeve të banesave, treguesve monetarë dhe makroekonomikë; (ii) lidhja ndërmjet çmimeve të shtëpive dhe treguesve ekonomikë ka ndryshuar përgjatë kohës; (iii) efektet e goditjeve në para dhe kredi janë më të forta kur çmimet e banesave lulëzojnë; (iv) ecuria e çmimit të banesave përbën shqetësim për qëndrimin e politikës monetare.

1.3 ARTIKUJ KËRKIMORË

“Ku është shënjestrimi i inflacionit si një standard monetar global?” Claudio Borio, BIS (Bank for International Settlements)

Që në fillimet e tij, shënjestrimi i inflacionit është përhapur për t'u bërë “de facto” standardi monetar global, ku historikisht, vetëm standardi i arit ka pasur një jetëgjatësi më të gjatë. Inflacioni i shënjestruar ka kontribuar në forcimin e një regjimi me inflacion të ulët, edhe përballë rritjes së inflacionit pas Covid, por ky rrugëtim nuk ka qenë aspak i lehtë. Objektivi i inflacionit duhej të përballlej me rritjen

e paqëndrueshmërisë financiare, atë të krizës më të madhe financiare globale, si dhe periudhën pas saj, duke nënvizuar edhe hapësirën e manovrave të politikave monetare. Materiali i vlerëson këto sfida dhe merr në konsideratë rregullimet e mundshme të kornizës që përfshijnë një konsideratë më sistematike të dëmit afatgjatë që faktorët financiarë mund të shkaktojnë në ekonomi dhe të rëndësisë së marzheve të sigurisë në drejtimin e politikës monetare.

<https://www.bis.org/publ/work1230.pdf>

“Shërbimi i borxhit agregat dhe kufiri i kredisë private”, Mathias Drehmann, Mikael Juselius, Sarah Quincy, BIS (Bank for International Settlements).

Materiali shqyrton raportin e shërbimit të borxhit (DSR) si një tregues të mirë teorik për të vlerësuar rrezikun sistematik. DSR ka veçorinë e dëshirueshme që luhatet rreth një niveli të qëndrueshëm, gjë që i bën sinjalet e paralajmërimit të hershëm të lehta për t'u kuptuar dhe komunikuar. Në të kundërt, treguesit aktualë të paralajmërimit të hershëm (EWI) të bazuar në zhvillimet e kreditit nuk kanë interpretime të qarta ekonomike dhe kërkojnë heqjen e trendit statistikor, duke zvogëluar saktësinë dhe dobinë e tyre për politikëbërësit makroprudencialë. Rishikimi i literaturës tregon se DSR jep sinjale shumë të sakta paralajmëruese të hershme për krizat dhe ngadalësimet e ardhshme ekonomike, duke tejkalluar treguesit tradicionalë të bazuar në kredi. Duke e zgjeruar matjen e DSR në vitet 1920 - një kontribut i ri në këtë punim – autorët demonstrojnë efektivitetin e tij si EWI (tregues aktualë të paralajmërimit të hershëm) përgjatë periudhave të ndryshme historike dhe tregojnë se DSR vepron si një kufi i sipërm për thellimin e mirë financiar.

<https://www.bis.org/publ/work1235.pdf>

“Përcjellja e politikës monetare në çmimet e konsumit: Dëshmi nga të dhënat granulare të çmimeve”, nga Anastasia Allayioti, Lucyna Górnicka, Sarah Holton, Catalina Martínez Hernández, BQE (Banka Qendrore Evropiane)

Ky material dokumenton se rreth 33% e shportës së inflacionit bazë në Eurozonë është e ndjeshme ndaj goditjeve të politikës monetare, si dhe vlerëson mekanizmat e mundshëm teorikë që nxisin ndjeshmërinë. Rezultatet sugjerojnë se zërat e natyrës diskrecionale, siç reflektohen në një peshë më të lartë në shportën e konsumit të familjeve më të pasura, dhe atyre me një rol më të madh kredie në financimin e blerjeve të tyre, priren të jenë më të ndjeshëm. Artikujt jo të ndjeshëm më shpesh i nënshtrohen çmimeve të administruara dhe përfshijnë artikuj jo diskrecionalë, si qiratë dhe shërbimet mjekësore. Autorët gjejnë se intensiteti i energjisë nuk duket se ndikon rezultatet e tyre dhe se artikujt e ndjeshëm nuk dominohen nga mallra të qëndrueshme, por janë të ndarë relativisht në mënyrë të barabartë midis mallrave dhe shërbimeve. Vlerësimet mbi zgjedhje të ndryshme tregojnë se ndikimi i goditjeve të politikës monetare në inflacionin bazë është bërë më i ndjeshëm kohët e fundit.

<https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/scpwps/ecb.wp3003~78aa7cc112.en.pdf?419ba7aaad637a2efb80aa503bfe652b>

“Kush nuk ka llogari bankare në Shtetet e Bashkuara dhe pse?”, nga Paul Calem, Chris Henderson, Jenna Wang, Banka Qendrore e Filadelfias.

Ky material eksploron në mënyrë të detajuar faktorët që lidhen me të mos pasurit një llogari bankare midis familjeve amerikane dhe se si kjo përqindje ka evoluar midis viteve 2015 dhe 2019, bazuar në të dhënat e anketës dyvjeçare të FDIC-së për familjet. Analiza tregon se të ardhurat janë faktori më i rëndësishëm për të shpjeguar diferencën midis familjeve që kanë një llogari bankare përkundrejt atyre që nuk kanë, ndjekur faktorët e tjerë si raca dhe përkatësia etnike e individëve.

Rezultatet tregojnë se pa llogari bankare rezultojnë më së shumti individët beqarë dhe individët me aftësi të kufizuara dhe më pak individët e rinj. Faktorë të tjerë lidhen me mungesën e aksesit digjital, si dhe të qenurit një emigrant ilegal. Gjithashtu vlerësimet në nivel shtetesh brenda SHBA-së tregojnë se në shtetet ku ka një rritje të promovimit të edukimit financiar rezultojnë me një përqindje më të ulët për të mos pasur llogari bankare. Në përgjithësi, gjetjet sugjerojnë se vazhdimi i përpjekjeve të fundit nga politikëbërësit për të kapërcyer ndarjen digjitale në zonat rurale dhe urbane dhe për të rritur edukimin financiar mund të ndihmojë në zgjerimin e përfshirjes financiare.

https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=5100477#

2 AKTIVITETE KËRKIMORE

2.1 WORKSHOP-I XVIII I KËRKIMEVE EKONOMIKE PËR EVROPËN JUGLINDORE, TIRANË, 19-20 NËNTOR 2024

Banka e Shqipërisë organizoi më 19-20 nëntor 2024, edicionin e 18-të të Workshop-it të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore, gjatë së cilit u prezantuan dhe u diskutuan 25 materiale studimore, prej të cilave 8 materiale kanë për autorë punonjës të Bankës së Shqipërisë. Qëllimi i këtij workshop-i është që nëpërmjet prezantimit dhe diskutimit të punëve dhe projekteve kërkimore të kryera nga Banka e Shqipërisë dhe nga bankat e tjera qendrore, të shërbejë si një forum për shkëmbimin dhe diskutimin e punëve kërkimore shkencore në lidhje me temat e bankingut qendror. Më poshtë është tërësia e temave të prezantuara:

1. "Interest Rate Pass-through under a Currency Board Regime: Evidence from Bosnia & Herzegovina", Emina Žunić Dželihodžić, Emina Milišić (Central Bank of Bosnia and Herzegovina).
2. "Assessing Convergence by Exploiting the Resurrection of the Phillips Curve", Nico Petz, Thomas O. Zoerner (Oesterreichische Nationalbank).
3. "The effects of selective price restrictions on inflation: Lessons from Croatia", Ivan Žilić, Davor Kunovac (Croatian National Bank).
4. "Do exogenous exchange rate movements drive changes in deposit euroization in CESEE?", Thomas Scheiber, Julia Wörz, Nico Petz (Oesterreichische Nationalbank).
5. "Benefits and Costs of Integration Albania-Kosovo from the Perspective of Social Accounting Matrices and Macroeconomic Modeling", Altin Tanku, Lorena Skufi, Esida Bujupi (Bank of Albania; World Bank).
6. "An analysis of environmental (trade) globalization (or de-coupling) trends in the case of Western Balkan Countries", Gerti Shijaku, Elona Mulgeci (Bank of Albania).
7. "Trade (environmental) globalization, economic growth and productivity in Western Balkan countries", Gerti Shijaku (Bank of Albania).
8. "Do Consumers Shape Environmental Proactivity in Southeast Europe? Insights Into Business Planning and Organizational Strategies", Rodica Ianole-Călin, Edvin Zhllima, Brunilda Kosta (University of Bucharest, Romania; Agricultural University of Tirana, University of Tirana).
9. "Inflation and pandemic in Spain", Leonardo Tariffi (Pompeu Fabra University, Barcelona, Spain).
10. "Commodity Prices and Inflation Nexus: Case of Türkiye", Erhan Iscan (Çukurova University, Adana, Turkey).
11. "Global Inflation Dynamics in the Face of Climate Change: A Unified Approach Using the Climate Condition Index (CCI)", Tural Yusifzada (Central Bank of Azerbaijan).
12. "Where did pandemic savings go? Uneven accumulation and spending patterns", Andrea Colabella, Elisa Guglielminetti, Concetta Rondinelli (Banca d'Italia).

13. "Digital transformation of banks in Albania: The results of the Albanian Banking Sector Digital Survey 2024", Margerita Topalli, Lindita Molishti (Bank of Albania).
14. "Electoral competition, Corruption, and Tax Evasion: Understanding Trade Misinvoicing", Drini Imami (Agricultural University of Tirana).
15. "Fiscal Multipliers in a Permanent Liquidity Trap", Alice Albonico, Guido Ascari, Alessandro Gobbi (University of Milan-Bicocca, Italy).
16. "Albania in Figures: Activity of the Banking System in the Period 1944 – 1990", Fiqiri Baholli (Bank of Albania).
17. "Monetary versus Capital-Based Macprudential Transmission - Efficiency and Effectiveness: Evidence from Central and South-Eastern European Banking Sectors", Milan Eliskovski, Neda Popovska-Kamnar (National Bank of the Republic of North Macedonia; Palladium Group).
18. "Impact of Monetary Policy on House Prices: A Structural VAR Approach," Gülnihal Tüzün (Central Bank of the Republic of Turkey).
19. "The Moderating Effects of the Banking and Financial Sector in Achieving Sustainable Development Through Economic Growth, Energy Consumption, and Decarbonization: Dynamic Panel Estimation for The Western Balkans", Güngör Turan, Vangjel Toto (Epoka University, Tirana, Albania).
20. "Remittances and poverty in Albania", Elona Dushku (Bank of Albania).
21. "FDI round-tripping: What are the main factors? The case of selected OECD countries", Magdolna Sass, Imre Ferő (University of Budapest, Hungary).
22. "Financial Development, International Reserves, and Real Exchange Rate Dynamic", Meri Papavangjeli (Bank of Albania).
23. "Deconstructing Monetary Policy Surprises— Do Systematic Changes", Marina Koça (University College London, UK).
24. "Assessing the Semantic Orientation in Bank of Albania's Monetary Policy Reports' communication terminology ", Orion Garo (Bank of Albania).
25. "Improving the capture of platform economic activity. The case of Short-Term Rental Platforms", Miriam Scaglione (Institute Tourism-ITO, HES-SO Valais/Wallis, Switzerland).
26. "Investigating the potential for bias arising from deep learning networks used on a low default portfolio", Alexie Alupoaei, Florian Neagu, Bogdan Negrea (National Bank of Romania, Bucharest University, Romania).

Prezantimet e materialeve gjenden në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, si më poshtë:

[https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime Kerkimore/Takimi i Kerkimit Ekonomik per Evropen Juglindore.html](https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime%20Kerkimore/Takimi%20i%20Kerkimit%20Ekonomik%20per%20Evropen%20Juglindore.html)

2.2 ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2024"

Banka e Shqipërisë gjatë muajit dhjetor të vitit 2024, shpalli finalistët e «Çmimit të Guvernatorit për Diplomën më të Mirë», një konkurs që organizohet prej 18 vitesh me qëllim nxitjen dhe provimin e kërkimit shkencor të të rinjve me fokus bankingun qendror. Në konkursin e vitit 2024 morën pjesë 24 studentë të niveleve të ndryshme studimore, me temat e diplomave të tyre

mbi objektivat dhe politikat tradicionale të bankave qendrore, pa lënë mënjanë problematikat që lidhen me ndryshimet klimatike, edukimin dhe përfshirjen financiare të popullatës dhe sistemeve të pagesave.

Me çmimin e parë u vlerësua Markelian Blacëri, student në Universitetin e Padovës, me temën e diplomës: "Hijet afatgjata të politikës monetare: A mund të ndikojnë goditjet e politikës në normën natyrore të papunësisë?". Me çmimin e dytë u vlerësua Endri Deda, student në Universitetin e Parisit Dauphine-PSL, për temën "Efekti i Marrëveshjeve të thella të tregtisë në flukset e investimeve të huaja direkte". Ndërsa me çmim të tretë u vlerësua Eneda Gjoka, studente e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, me temën "Përdorimi i Machine Learning për parashikimin e inflacionit në tendencat ekonomike".

2.3 PJESËMARRJA NË AKTIVITETE TË TJERA

- *Prezantimi i materialit me temë "Akses i materialit me temë " Aksesi në financë dhe kredia informale në Shqipëri", nga Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve, në workshopin e organizuar nga Banka qendrore e Bosnje-Hercegovinës 30-31 tetor, në Sarajevë.*
- *Prezantimi i materialit me temë "Përzgjedhja e strukturës së rrjetit neural me një ilustrim mbi përcaktuesit e çmimit të banesave në Shqipëri" nga Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë; Blerina Vika, Prof. i Asoc., Departamenti i Statistikave dhe Informatikës së Zbatuar, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në konferencën shkencore ndërkombëtare të organizuar nga Akademia e Shkencave, me temë "Horizonti AI - një epokë e re kreativiteti dhe inovacioni"*
- *Prezantim i materialit me temë "An analysis of environmental (trade) globalization (or de-coupling) trends in the case of Western Balkan Countries", nga Gerti Shijaku dhe Elona Mulgeci, Departamenti i Kërkimeve në Emerging Markets Workshop, organizuar nga Banka Qendrore e Austrisë dhe Banka Qendrore e Spanjës më 9-10 dhjetor 2024, në Vjenë.*
- *Prezantim në Workshopin me temë "Përfshirja e ndryshimeve klimatike dhe tranzicionit të gjelbër në analizën makroekonomike", nga Margerita Topalli, Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve (BSH) organizuar nga CEF në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe banka të tjera qendrore..*
- *Prezantim i materialit me temë "Toni komunikues i Raportit të Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë: Një vlerësim i orientimit semantik", nga Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve në tetor të vitit 2024 në seminarin teknik të Bankës së Shqipërisë. Materiali prezantoi vlerësimin e indeksit dikotomik të toneve të komunikimit të gjuhës së shkruar në raportet tremujore të BSH-së, gjatë periudhës 2010-2024. Paralelisht, vlerëson se si korrelojnë ky indeks me REPO-n, RGDP, yield-et e bonove të thesarit dhe tregues të tjerë të normave të interesit.*
- *Prezantim i materialit me temë "Implikimet e ngjarjeve ekstreme të motit për disbalancat makroekonomike dhe financiare në vendet e EQIJ" nga Meri Papavangjeli, si dhe i materialit me temë*

3 LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA**Banca d'Italia**

[\(http://www.bancaditalia.it/studiricerche/\)](http://www.bancaditalia.it/studiricerche/)

Bank of Canada

<http://www.bankofcanada.ca/research/>

Banco de Espana

<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>

Bank of England

<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>

Bank of Finland

http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm

Bank of Greece

<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>

BIS Central Bank Research Hub

<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>

Czech National Bank

[\(http://www.cnb.cz/en/research/\)](http://www.cnb.cz/en/research/)

Deutsche Bundesbank

http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php

European Central Bank

<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>

Federal Reserve

<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>

International Journal of Central Banking

<http://www.ijcb.org/>

National Bureau of Economic Research

<http://www.nber.org/>

International Monetary Fund

<http://www.imf.org/external/pubind.htm>

Oesterreichische Nationalbank

http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp